

**Akti i Themelimit dhe Statuti
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Blueline Construction” Sh.p.k**

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi;

Sot, në Tiranë, më datë **03.03.2022**, Ortakët e poshtëshënuar, mbliidhen dhe bien dakort të themelojnë Shoqërinë “**Blueline Construction**” Sh.p.k, e cila do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

Ortakët e shoqërisë janë:

1. **Shoqëria “Diagonal Projektim & Zbatim” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K71602002R, me adresë Rruga Beqir Luga, Pallati i Ri, Shkalla 1, Kati 0, Tiranë, përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm **Z. Nikolin Jaka**, atësia Frrok, lindur më 17/05/1972, në Mirditë dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me letërnjoftimin ID Nr. 034406736 dhe Nr. Personal H20517177N, e-mail: jakaniko@gmail.com sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm Nr. 2, dt 02.03.2022.
2. **Shoqëria “D Energy Albania” Sh.p.k**, shoqëri e themeluar dhe e regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Bizneseve në Shqipëri, me NUIS M11724036S: me seli në Tiranë Njesia Bashkiake nr.5, Rr.Abdyl Frasheri, nr. 31, Pallati Hekla, kati i 3t e përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë, shoqëria e të drejtës kosovare “Devolli Group shpk”, regjistruar me NUI: 811252642, me seli në Kosovë, Miradi e Eperme - fushe Kosove, e përfaqësuar nga **z. Blerim Devolli**, shtetas kosovar, lindur me 20.02.1972, në Pejë dhe banues në Prishtinë, Kosove, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i pasaportes n. P01464766 dhe nr. Personal 1009459509; e-mail: blerim.devolli@devolligroup.com; sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm nr. 1/22, dt.02.03.2022.

**KAPITULLI
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Emri i Shoqërisë është “**Blueline Construction**” Sh.p.k, këtu e mëposhtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është e themeluar në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga “Beqir Luga”, Pallati Nr. 3, Shk. 1, Kati 0, Zona Kadastrale 8150, Shqipëri.**
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale, dhe/ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3 Objekti

3.1 Objekti i shoqërisë do të jetë:

“Investimi me qëllim zhvillimin, ndërtimin, administrimin dhe shitjen e objekteve turistike/hoteliere dhe rezidenciale (hotele, apart-hotele, vila, apartamente banimi, ambiente shërbimi, qendra tregtare, ambiente rekreative dhe argetuese, etj.)

3.2 Kryerja e aktiviteteve për të cilat nevojiten leje, licenca, dhe/ose autorizime përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve.

Neni 4 Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E KAPITALIT

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **20,000 EUR € (njetetë mijë euro)** i cili është i ndarë në **2 (dy) kuota**.

5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:

– **Shoqëria “Diagonal Projektim & Zbatim” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K71602002R, me adresë Rruga Beqir Luga, Pallati i Ri, Shkalla 1, Kati 0, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Nikolin Jaka**, atësia Frrok, lindur më 17/05/1972, në Mirditë dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me letërnjoftimin ID Nr. 034406736 dhe Nr. Personal H20517177N, **zotërues i 1 (një) kuote të shoqërisë me vlerë nominale 10,000€ (dhjetëmije euro), që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar, me të drejtë vote.**

– **Shoqëria “D Energy Albania” Sh.p.k**, shoqëri e themeluar dhe e regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Bizneseve në Shqipëri, me NUIS M11724036S: me seli në Tiranë Njesia Bashkiake nr.5, Rr.Abdyl Frasheri, nr. 31, Pallati Hekla, kati i 3t e përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë, shoqëria e të drejtës kosovare “Devolli Group shpk”, regjistruar me NUI: 811252642, me seli në Kosovë, Miradi e Eperme - fushe Kosove, e përfaqësuar nga z. Blerim Devolli, shtetas kosovar, lindur më 20.02.1972, në Pejë dhe banues në Prishtinë, Kosovë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i pasaportes n. P00539818 dhe nr. Personal 1009459509, **zotërues i 1 (një) kuote të shoqërisë 10,000€ (dhjetëmije euro), që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të kapitalit themeltar, me të drejtë vote.**

5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e shoqërisë. Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë.

5.4 Shoqëria mund të marrë nga ortakët e Shoqërisë hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi, nën përgjegjësi të barabarta sipas aksioneve që përfaqëson dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.5 Adresat e ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet nëse do të ketë më vonë.


Neni 6 Transferimi i kuotave

- 6.1** Me përjashtim të rastit kur me unanimitet ortakët vendosin ndryshe, ortakët nuk mund të vënë peng, barrë siguroese ose çfarëdolloj barre tjetër mbi kuotat e shoqërisë dhe as nuk mund ta vënë kolateral mbi truallin objekt investimi, karabinanë, apo çdo objekt i ndërtuar apo në ndërtim e sipër që mund të regjistrohet në regjistrat hipotekore dhe është i lidhur pazgjydhshmërisht me Projektet e shoqërisë.
- 6.2** Me përjashtim të rastit kur me unanimitet ortakët vendosin ndryshe, nuk mund të transferohet e drejta e pronësisë mbi kuotat e shoqërisë nga asnjëri prej ortakëve tek palët e treta nëpërmjet *(i)* një akti dhurimi/ pa pagesë inter vivos, *(ii)* një akti shkëmbimi (neni 757 i Kodit Civil), *(iii)* një kontributi në shoqëri të treta ose *(iv)* çfarëdolloj akti tjetër që drejtëpërsëdrejti ose indirekt realizon transferimin e pronësisë se ortakëve të shoqërisë tek të tretë.
- 6.3** Kuotat e shoqërisë janë të transferueshme inter vivos, kundrejt pagesës, sipas procedurës së përcaktuar nga paragrafët në vijim të këtij neni, duke konsideruar ndalimin/ përjashtimin nga transferimi sipas pikës 6.2 më sipër.
- 6.4** Ortaku që synon të transferojë të drejtën e pronësisë mbi kuotën që zotëron (në vijim “Ortaku Shitës”), duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim të gjithë ortakët e tjerë (në vijim “Ortakët e tjerë”) nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrjeje (në vijim “Njoftimi”) të dërguar në adresën përkatëse të ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë çmimin e kalimit të kuotës.
- 6.5** Ortakët e tjerë do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar, me të njëjtin çmim sikurse të përcaktuar në Njoftim. Nëse cilido prej ortakëve të tjerë synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, duhet të njoftojë Ortakun Shitës me letër rekomande me njoftim marrjeje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së Njoftimit. Në të kundërt, do të konsiderohet se është hequr dorë prej së drejtës së parablerjes.
- 6.6** Nëse më shumë se një prej Ortakëve të Tjerë ka ushtruar të drejtën e parablerjes, kuotat e ofruara do të blihen prej tyre në përpjestim me kuotat përkatëse që ata zotërojnë në shoqëri, me të njëjtat kushte dhe afate të propozuara nga Ortaku Shitës.
- 6.7** Nëse asnjëri prej Ortakëve të Tjerë nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të sipërshënuar, Ortaku Shitës do të jetë i lirë të shesë/ transferojë tek i treti kuotën e përcaktuar në Njoftim, i cili duhet të përmbajë: (i) emrin e të tretit blerës, (ii) çmimin për transferimin e kuotës. Transferimi i kuotës së zotëruar nga ortaku do të kryhet vetëm pas miratimit unanimit nga Asambleja të çmimit të shitjes, i cili nuk duhet të jetë më i ulët nga ai i përcaktuar në nenin 6.4. Miratimi nga Asambleja nuk do të vonohet apo pengohet pa shkaqe të arsyeshme, të cilat mund të lidhen vetëm me rregullsinë e transaksionit.
- 6.8** Kushtet e parashikuara më sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një ortak tek një Shoqëri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij Ortaku ose kontrollon këtë Ortak ose në rast transferimi nga një ortak tek një pasardhës ose paraardhës i drejtëpërdrejtë i tij ose tek bashkëshorti apo bashkeshortja, nëse është dhënë pëlqimi me shkrim nga të gjithë ortakët e shoqërisë. Në këtë Statut, fjala “kontroll” ka të njëjtin kuptim të përdorur në ligjin tregtar.

KREU III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7 Asambleja e Përgjithshme

- 7.1** Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 7.2** Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, pavarësisht janë ose jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakort me këto vendime.
- 7.3** Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:



- a) Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori/(-ët);
- b) Emëron dhe shkarkon administratorin/(-ët) në përputhje me rregullat që përcaktohen në këtë Akt Themelimi dhe Statut;
- c) Emëron dhe shkarkon ekspertin/(-ët) kontabël dhe/ose likujduesin/(-ët) e Shoqërisë;
- d) Përcakton shpërblimin e administratorit/(-ëve), ekspertëve kontabël dhe likujduesve;
- e) Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
- f) Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
- g) Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- h) Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- i) Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- j) Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Thirrja

- 8.1** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/(-rët) apo prej Ortakëve zotërues të të paktën 5% të votave sipas legjislacionit në fuqi.
- 8.2** Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim me lajmërim marrjeje ose postë elektronike me lajmërim marrjeje.
Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet Ortakëve brenda 5 (pesë) ditëve para datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 8.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 8.4** Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 8.5** Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë/autorizim me shkrim, i cili do të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë edhe mbledhje vijuese me të njëjtin rend dite, Administratori/(-ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.
- 8.6** Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike të audiove dhe video-konferencës. Përdorimi i mjeteve elektronike për t'u mundësuar Ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e Ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 9

Proçesi i Vendimmarrjes


- 9.1** Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në çdo rast të paktën një herë në vit.
- 9.2** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas pikës 9.4 të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë 100% (njëqind përqind) të numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ose mjete elektronike.
Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

- 9.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me 51% (pesëdhjetë e një përqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës, në lidhje me çështje për të cilat ligji dhe/ose ky Statut nuk kërkon një shumicë të cilësuar të përcaktuar në pikën 9.4 më poshtë.
- 9.4 Vendimet e mëposhtme do të konsiderohen Vendime Strategjike për veprimtarinë e Shoqërisë dhe do të jenë të vlefshme vetëm nëse për to votojnë Pro Ortakët që veçmas ose bashkarisht përfaqësojnë **të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind)** të kapitalit themeltar të saj ose 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës:
1. Ndryshimin e këtij Statuti dhe Akti Themelimi;
 2. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
 3. Shpërndarjen e fitimeve (dividenti) dhe mbulimin e humbjeve;
 4. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 5. Emërimin dhe Shkarkimin e Administratorëve të Shoqërisë dhe të Drejtuesve të Lartë të shoqërisë në pozicionet e mëposhtme:
 - a. Drejtuesi Teknik i Shoqërisë;
 - b. Supervizori i Punimeve;
 - c. Studio Arkitekture dhe Studio Inxhinierike që do të përgatisë Projektin;
 - d. Drejtuesi i Departamentit të Financës;
 - e. Drejtuesi i Departamentit të Shitjeve;
 - f. Drejtuesi i Departamentit të Marketingut;
 - g. Drejtuesi i Departamentit të Projekteve.
 6. Miratimin e biznes planit të Projektit;
 7. Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë;
 8. Shitjen, dhurimin, dhënien me qira apo disponimi në çdo formë i pasurisë së paluajtëshme të shoqërisë;
 9. Shitjen, dhurimin, dhënien me qera apo disponimi në çdo formë i pasurisë së luajtëshme të shoqërisë me vlerë më të madhe se 100,000 Euro;
 10. Nënshkrimi i çdo lloj kontrate e çfarëdolloj forme me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 100,000 Euro;
 11. Çdo financim në lidhje me Projektet e shoqërisë;
 12. Çdo financim nga bankat ose institucionet e tjera financiare;
 13. Vendosjen peng ose kolateral të kuotave në Shoqëri si dhe vendosjen peng ose kolateral të çdo pasurie të shoqërisë;
 14. Përzgjedhjen e nënkontraktorëve për proçese të caktuara pune në Projektet e shoqërisë gjatë fazës së ndërtimit të tyre kur vlerat e zërave për nënkontraktorin respektiv janë të barabarta ose më të larta se 30% (tridhjetë përqind) e buxhetit të miratuar për Projektin. Nëse vlera e zërit të nënkontraktorit respektiv në buxhetin total është më pak se 30% (tridhjetë përqind), zgjedhja e nënkontraktorit i takon ortakut maxhoritar.
 15. Përcaktimin e listës së çmimeve për shitjen e njësive sipas *i)* kategorisë së përdorimit të njësive dhe *ii)* llojit të njësive;
 16. Përcaktimi i raportit të përgjithshëm ndërmjet njësive që do të përcaktohen për shitje dhe njësitet që do t'u jepen në përdorim apo me qira palëve të treta;
 17. Vlera e investimeve në të cilat Shoqëria do të duhet të paguaj kapital monetar, do të paguhet nga Ortakët në mënyrë proporcionale sipas kuotave të aksioneve të Shoqërisë.

Neni 10

Largimi i Ortakut të Shoqërisë

- 10.1 Ortaku mund të largohet nga Shoqëria në rast se:
- i. Ortakët e tjerë apo Shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, me faj ose nga pakujdesia;
 - ii. Është penguar të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij Statuti dhe Akti Themelimi;
 - iii. Shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme;



- iv. Egzistojnë shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimësinë e ortakërisë në këtë shoqëri ose është shkelur parimi i mirëbesimit dhe i qëllimit për të cilin është formuar kjo ortakëri.
- 10.2 Për ushtrimin e të drejtës së largimit zbatohet Ligji 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
Administratori/(-ët) thërresin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pas komunikimit të njoftimit të largimit për të vendosur nëse ortakut do t'i likujdohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
- 10.3 Për vlerësimin e çmimit të kuotës të ortakut të dorëhequr që duhet shlyer, do të merret parasysh vlera sipas kërkesës së tregut në shit-blerjen e kuotave në momentin e largimit të ortakut.

Neni 11

Organi i Administratorit

- 11.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/(-ë), i/(-të) emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
Në aktin e emërimit mund të caktohen kufizime të tagrave të administratorit/(-ëve).
- 11.2 Shoqëria do të administrohet bashkarisht nga individët e mëposhtëm:
- **Lorik Fejzullahu**, atësia Vesel, lindur më 17/03/1980, në Mitrovicë dhe banues në Prishtinë, shtetas kosovar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. ID0728254 dhe Nr. Personal 1011435471; e-mail: lorik.fejzullahu@devolligroup.com
 - **Ermelinda Bajraktari**, atësia Pëllumb, lindur më 21/11/1986, në Ballsh dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e pajisur me letërnjoftimin ID me Nr. 033548244 dhe Nr. Personal I66121040B; e-mail: ermelinda_bajraktari@yahoo.com
- 11.3 Mandati i Administratorëve është për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ripërtëritje.
Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë Administratorët në përputhje me të drejtat e votes të ortakeve të Shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 11.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratorët e lartpërmendur.
- 11.5 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin e Administratorëve, Administratorët kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
 - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
 - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave;
 - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduara, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve pasi të jenë miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë;
 - Dorëzimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit të dokumentave dhe të të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve ku ligji parashikon ndryshe;
 - Raportimin në Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
 - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 11.6 Administratorët mund të autorizojnë nëpërmjet një prokure të posaçme, një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 11.7 Administratorët janë përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në

bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

- 11.8 Administratorët kanë të drejtë të rimbursohen për shpenzimet e kryera për shkak të funksionit të tyre si dhe të marrin shpërblim, masa e të cilit do të përcaktohet me një marrëveshje të veçantë të miratuar me Vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.
- 11.9 Çdo veprim i Administratorëve apo kompetencë e tyre do të ushtrohet bashkërisht dhe me nënshkrim të dyfishtë, me përjashtim të rasteve ku Asambleja e Përgjithshme me vendim unanim të ortakëve vendos ndryshe.

Kufizime të kompetencave:

- 11.10 Administratorët kanë kufizimet e kompetencave si më poshtë, të përcaktuara dhe nuk mund të veprojnë veçmas dhe pa marrë miratimin me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas kuoromit të kërkuar në pikën 9.4 më sipër:
- Të marrin vendime dhe të kryejnë veprime mbi një, disa ose të gjitha çështjet e përcaktuara në pikën 9.4 të nenit 9 të këtij Statuti, pa marrë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme sipas kuoromit të përcaktuar në këtë pikë;
 - Të nënshkruajnë Kontrata, akte, marrëveshje të çfarëdolloj natyre dhe forme, me çdo lloj pale të tretë, me një vlerë të barabartë me ose me të madhe se **100,000 € (njëqind mijë euro)**, pa marrë miratimin me vendim të Asamblesë së Shoqërisë sipas pikës 9.4 të këtij statuti.
- 11.11 Për një, disa ose të gjithë kategorinë e veprimeve të listuara në pikën 9.4 të nenit 9 të Statutit dhe në përputhje me Kufizimet e Kompetencave si më sipër të përcaktuara, Administratorët do të veprojnë vetëm me miratim me vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë sipas pikës 9.4 më sipër. Asambleja e Përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sipas pikës 9.3, të këtij Statuti, ka të drejtë të ngre padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit dhe/ose të statutit të Shoqërisë.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 12

Viti financiar

- 12.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë, në përputhje me ligjet në fuqi.
- 12.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja e Fitimeve


- 13.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimeve.
- 13.2 Në rast se pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare Shoqëria rezulton me humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me mbulimin e humbjeve.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Ligji i Zbatueshëm

- 14.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.



Neni 15

Mosmarrëveshjet

15.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtyre statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë nga Ortakët Themelues të Shoqërisë.

ORTAKËT NËNSHKRUES TË
AKTIT TË THEMELIMIT DHE TË STATUTIT TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
***** BLUELINE CONSTRUCTION Sh.p.k *****

“Diagonal Projektim & Zbatim” Sh.p.k
Përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm

NIKOLIN JAKA

Nikolin Jaka



“D Energy Albania” Sh.p.k
Përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm i
Shoqërisë Devolli Group si Ortakë
BLERIM DEVOLLI

Blerim Devolli
